

LIGJ
Nr.7710, datë 18.5.1993

PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshilli të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton sistemin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore për t'u dhënë ndihmë ekonomike familjeve të shtetasve shqiptarë, të cilëve u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht, ose i kanë ato të pamjaftueshme.

Në rastet kur është e nevojshme dhe e mundshme, në vend të ndihmës ekonomike, ose si shtesë e saj, ofrohen shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore.

Neni 2

Nuk përfitojnë nga ky ligj:

- a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë shtetit;
- b) refugjatët e ardhur dhe
- c) personat që kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave.

Neni 3

PËRKUFIZIMET

1. Termi "familje" nënkupton prindërit dhe fëmijët që ata kanë në ngarkim, si dhe çdo person tjetër, të cilët bashkëjetojnë ekonomikisht në të njëjtën strehë.

2. Termi "familje e madhe" nënkupton familjen me më shumë se gjashtë anëtarë.

3. Termi "vendbanim" nënkupton vendin ku familja jeton në mënyrë të vazhdueshme. Çdo familje ka vetëm njëvendbanim.

4. Termi "vendqëndrim" nënkupton çdo vend ku banohet për një kohë të caktuar për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak ose vuajtje dënimi. Çdo familje mund të ketë më shumë se një vendqëndrim.

5. Termi "refugjat" nënkupton shtetasit e vendeve të tjera, që vijnë në Shqipëri për shkak të luftës ose ngjarjeve të tjera kaastrofike. Ndihma për refugjatët rregullohet me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

6. Termi "e ardhura e familjes" nënkupton të ardhurat e gjithë anëtarëve të familjes, duke përfshirë edhe ata që përkohësisht jetojnë ose punojnë jashtë shtetit.

7. Termi "pagesë e njëhershme" nënkupton pagesën e ndihmës menjëherë dhe jo në mënyrë periodike.

8. Termi "bllok ndihme" nënkupton ndihmën, kryesisht në para, e cila jepet nga shteti për një qëllim të caktuar dhe një periudhë të caktuar.

9. Termi "veprimtari ekonomike" përfshin punësimin, vetëpunësimin, punën që kryhet pa pagesë pranë një anëtari të vetëpunësuar të familjes, biznesin e vogël privat, sipërmarrjen, si dhe çdo

veprimtari tjetër të ngjashme me këto, që u sjell të ardhura individëve dhe familjeve të tyre.

10. Termi "pagesa në sigurimet shoqërore" përfshin të gjitha llojet e pagesave me para në dorë nga sigurimet shoqërore, pavarësisht nga shkaku për të cilin janë dhënë dhe nga sistemi me të cilin janë paguar.

11. Termi "kapital" përfshin çdo lloj prone që mund të sjellë të ardhura.

12. Termi "veprim i qëllimshëm" nënkupton çdo veprim që ka synim të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe për mundësi punësimi. "Veprim i qëllimshëm" përfshin edhe mospranimin e trajtimit mjekësor të duhur në rastet e përdorimit të drogës ose me tepricë të alkoolit, si dhe në çdo rast tjetër, të përcaktuar me ligj.

13. Termi "të paaftë rëndë që nga fëmijëria" përfshin gjithë personat që janë bërë të paaftë përpara moshës 16 vjeç. Paaftësia e rëndë përcaktohet nga komisionet mjekësore përkatëse, veprimtaria e të cilave rregullohet me akte nënligjore.

14. Termi "person i moshuar" nënkupton çdo person që ka arritur moshën e pensionit sipas legjislacionit në fuqi.

15. Termi "jetim" nënkupton fëmijën pa prindër nën moshën 16 vjeç.

16. Termi "burime materiale" përfshin të gjitha mjetet monetare ose të ardhurat në natyrë që bëjnë të mundur jetesën.

17. Termi "administrator shoqëror" nënkupton një nëpunës publik të punësuar nga pushteti qëndror ose lokal, për të siguruar dhënien e ndihmës ekonomike ose për të administruar shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore.

KAPITULLI II FAMILJET E MBROJTURA

Neni 4

1. Ndihma ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptarë që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose nuk kanë të ardhura e burime materiale jetese nga:

- a) veprimtaria ekonomike;
- b) sigurimet shoqërore ose ndonjë sistem tjetër siguri;
- c) kapital.

2. Persona që nuk janë shtetas shqiptarë, mund të përfitojnë ndihmë dhe përkujdesje shoqërore pasi të kenë banuar 10 vjet në Shqipëri.

3. Nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë ekonomike, anëtarët e familjeve që kryejnë veprime të qëllimshme për ta përfituar atë.

Neni 5

1. Ndihmë ekonomike mund t'u jepet dhe familjeve që përkujdesen për një anëtar të saj i cili është:

- a) i verbër;
- b) i paaftë mendor;
- c) invalid i rëndë që prej fëmijërisë;

ç) person i paaftë që nuk mund të kujdeset për vetveten dhe për pasojë ka nevojë për ndihmën e nje personi tjetër, me kusht që ky anëtar i familjes të ketë të ardhura të pamjaftueshme ose t'i mungojnë fare ato, të mos përfitojë nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe të mos jetë i vendosur në ndonjë institucion publik të përkujdesjes shoqërore.

2. Administratori ka të drejtë t'i propozojë këshillit të bashkisë ose të komunës të ndërhyjë, në rastet kur:

a) familja nuk tregon kujdesin e duhur për personin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dhe

b) nevojat e personit kërkojnë vendosjen e tij në spital ose azil.

Neni 6

Familjeve bujqësore u jepet një ndihmë ekonomike e pjesshme për të plotësuar të ardhurat e tyre të pamjaftueshme, me kusht që ata të mos kenë të ardhura nga burime të tjera, përveç sipërfaqes së tokës, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6/a

Ndihmë ekonomike e pjesshme mund t'u jepet edhe familjeve të mëdha, me kusht që:

- a) këshilli i bashkisë ose komunës të ketë burime materiale të mjaftueshme për të bërë një gjë të tillë;
- b) kjo ndihmë të mos prekë interesat e familjeve të tjera që nuk kanë asnjë të ardhur.

KAPITULLI III NDIHMA EKONOMIKE

Neni 7

1. Ndhma ekonomike e plotë dhe e pjesshme jepet periodikisht si pagesë e menjëhershme.

2. Këshilli i bashkisë ose i komunës vendos për masën e ndihmës ekonomike, duke mbajtur parasysh fondet e parashikuara në buxhet dhe kriteret e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Masa e ndihmës ekonomike mujore për familjen do të jetë jo më pak se 70 për qind dhe jo më e madhe se 100 për qind e dy asistencave.

3. Kriteret për vlerësimin e nivelit të ndihmës, mungesës së të ardhurave dhe burimeve materiale për të përfituar ndihmë ekonomike, si dhe sasia minimale e pagesës së kësaj të fundit, mund të përcaktohet nga:

- a) Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politik dhe
- b) Këshilli i rrethit, bashkisë e komunës, duke mbajtur parasysh fondet e përcaktuara për këtë qëllim.

Neni 8

Dhënie e ndihmës ekonomike

1. Sasia e ndihmës ekonomike i jepet familjes, në bazë të vendimit që merret nga këshilli i bashkisë ose i komunës, pasi janë analizuar nevojat e saj.

2. Ndhma është:

- a) e plotë, për rastet kur mungojnë të ardhurat krejtësisht sipas përcaktimit të neneve 4 dhe 5;
- b) e pjesshme, kur plotëson të ardhurat e pamjaftueshme në bazë të vendimit të këshillit të bashkisë a të komunës, sipas përcaktimit të nenit 4 e 6.

3. Dhënia e ndihmës së pjesshme vlerësohet sipas të ardhurave të familjes. Masa e saj nuk është më e madhe se masa e plotë e ndihmës që marrin familjet pa asnjë të ardhur.

4. Familja që paguan qira banese, mund të marrë një shumë shtesë për pagimin e saj.

Këshilli i Ministrave përcakton masën e shtesës që i jepet familjes për qiranë e banesës.

Neni 9

Periudha e përfitimit

1. Këshilli i bashkisë ose i komunës përcakton periudhën e përfitimit në përputhje me natyrën e tij. Periudha e përfitimit, si rregull, nuk e kalon afatin një mujor.

Familja dhe personat që e përfitojnë ndihmën, deklarojnë se kushtet e tyre nuk kanë ndryshuar, në mënyrë që të përfitojnë pagesën për periudhën pasardhëse. Deklarimi shoqërohet me vërtetimin e zyrës së punës përkatëse, se nuk ka mundësi punësimi.

2. Në rastet kur nuk pritet ndryshim i shpeshtë i gjendjes të varfërisë, në rastet e paaftësisë, moshës më të vjetër se 70 vjeç, pronarëve të varfër të tokave, periudha e përfitimit mund të zgjatet në çdo rast deri në një vit.

Neni 10

Dhënia e pagesës së njëhershme

Ndihma ekonomike mund të jetë e njëhershme në raste të veçanta, të njohura nga këshilli i bashkisë ose i komunës, për të mbuluar shpenzimet e papritura që janë të domosdoshme për të jetuar.

Neni 11

Ndihma ushqimore

Në rastet kur është e domosdoshme dhe e përshtatshme, në vend të ndihmës ekonomike në para, këshilli i bashkisë ose i komunës mund të ofroj ndihmë ushqimore, në rastet kur:

- a) sigurimi i ushqimit në komunë është i vështirë ose i pamundur, duke bërë ndihmën në para të pavlefshme, ose
- b) është e nevojshme për arsye të veçanta shëndetësore.

KAPITULLI IV

SHËRBIMET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Neni 12

Shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore përfshijnë institucionet për personat e moshuar, për të paaftët fizikë ose mendorë e jetimët, si dhe institucionet e tjera të ngjashme që ndodhen në vartësi të pushtetit qendror a lokal, që përcaktohen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Polotikë.

Neni 13

1. Institucionet publike të përkujdesjes shoqërore për të moshuarit, për të paaftët mendorë ose fizikë dhe jetimët financohen nga Buxheti i Shtetit dhe administrohen nga:

- a) Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, në rastet kur ato shërbejnë për më shumë se një rreth.
- b) Këshillat e rretheve, kur ato shërbejnë për një rreth ose një numër komunash.
- c) Këshillat e bashkive ose komunave, kur ato i shërbejnë një qyteti ose një komune.

Buxheti i këtyre institucioneve përcaktohet nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe pushtetin lokal.

2. Në rastet kur institucionet varen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, kjo e fundit mund të lidhë kontrata me organe të tjera qendrore, pushtetin lokal dhe institucione të tjera publike të pavarura, për t'i përfshirë ato në realizimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore me rëndësi kombëtare dhe për të përcaktuar kushtet e angazhimit të tyre.

3. Në rastet kur institucionet administrohen nga këshillat e rretheve, bashkisë ose komunës, këto financohen nga Buxheti i Shtetit dhe drejtohen, mbikëqyren e ndihmohen profesionalisht nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

4. Rregullat e veprimtarisë në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore përcaktohen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

Neni 14

Pjesëmarrja financiare

1. Jetimët pa asnjë përkrahje, të moshuarit dhe personat e paaftë, pa asnjë të ardhur, pranohen pa pagesë në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore. Shteti mbulon shpenzimet e tyre.

2. Personat që kanë të ardhura personale, për t'u pranuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore, duhet të marrin pjesë në shpenzimet e shërbimit, në raport me të ardhurat e tyre.

3. Personat e vendosur në këto institucione që kanë të ardhura personale, do të paguajnë jo më

shumë se 100 për qind të kostos mesatare mujore të vitit paraardhës. Personave të vendosur në këto institucione do t'u jepen për shpenzime vetjake 10 për qind e kostos mesatare mujore të muajit paraardhës.

4. Personave që janë vendosur në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore, mund t'u përmirësohen kushtet e tyre kundrejt pagesës për shpenzime suplementare.

Neni 15

Shërbimet shoqërore joqeveritare

1. Institucionet e përkujdesjes shoqërore mund të administrohen nga persona privatë dhe organizata joqeveritare, me kusht që:

- a) të lidhin kontratë me Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë;
- b) të punësojë kuadro me kualifikimin e duhur profesional;
- c) të sigurojë kushte jo më pak të favorshme se ato të institucioneve publike të përkujdesjes shoqërore.

2. Kontrata duhet të përfshijë:

- a) identitetin e kontraktuesit;
- b) objektin e kontraktimit;
- c) natyrën e kujdesit që merr përsipër të realizojë kontraktuesi;
- ç) kushtet e punës në një institucion, duke përfshirë edhe rregullat financiare;
- d) kushtet dhe procedurat për pranimin dhe largimin e personave të vendosur në këto institucione;

dh) shkallën e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së qeverisë në drejtimin e institucionit, duke përfshirë edhe mbështetjen financiare.

3. Statutet dhe rregullat e institucioneve joqeveritare njihen dhe regjistrohen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

4. Personave të vendosur në këto institucione mund t'u kërkohet të paguajnë për kujdesin e treguar për ta në këto qendra.

5. Ministria e punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë e të Mbrojtjes së Mjedisit, përcakton mënyrën e raportimit e të mbikëqyrjes së institucioneve private të përkujdesjes shoqërore nga autoritetet shtetërore.

KAPITULLI V

AGJENCIA PËRGJEGJËSE E PUSHTETIT LOKAL

Neni 16

Këshilli Bashkiak dhe i Komunës

1. Sistemi publik i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore administrohet nga këshillat e bashkive dhe të komunave. Këto këshilla përgjigjen para Këshillit të Ministrave, për përdorimin e bllokndihmës për qëllimin e caktuar sipas këtij ligji.

2. Këshilli i bashkisë oes i komunës, të paktën një herë në muaj, duhet të vendosë për:

- a) familjet ose personat që përfitojnë ndihmën e plotë a të pjesëshme;
- b) masën e ndihmës;
- c) kthimin e parave ose ndërprerjen e ndihmës ekonomike në rastet e përfitimit pa të drejtë;
- ç) gjobën që duhet të paguajë për përfitimin pa të drejtë.

3. Këshilli i bashkisë dhe i komunës miraton kërkesën për ndihmë.

Neni 17

Seksionet e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki dhe komuna

Në çdo bashki e komuna ngrihet dhe funksionon seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shhoqërore, detyrat kryesore të të cilit janë:

- a) përcaktimi i nivelit të varfërisë të familjeve sipas kriterëve të vendosura në këtë ligj;
- b) propozimi për masën e ndihmës që i jepet familjes;
- c) hartimi dhe argumentimi i kërkesës për bllok ndihme çdo tremujor për bashkinë dhe komunën përkatëse;
- ç) raportimi në mënyrë periodike në Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

Neni 18

Administratorët shoqërorë

Çdo bashki ose komunë duhet të ketë një ose më shumë administratorë shoqërorë përgjegjës për verifikimin dhe rekomandimin e familjeve që kanë nevojë të marrin ndihmë ekonomike, si dhe vendosjen e personave në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Neni 19

Këshillat e rretheve

1. Këshillat e rretheve vendosin dhe përgjigjen për:
 - a) kërkesën për fond nga Buxheti i Shtetit për institucionet e përkujdesjes shoqërore që janë në vartësi të këshillit të rethit;
 - b) drejtimin e institucioneve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore të rethit;
 - c) zbatimin e kontroll-revizionit për kryerjen e shpenzimeve, për sistemin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, si dhe verifikimin e rasteve të përfitimit pa të drejtë në të gjithë rrethin.
 - ç) verifikimin e nivelit të varfërisë në të gjithë rrethin;
 - d) raportimin në organet qendrore të pushtetit.
2. Këshilli i rethit sipas legjislacionit në fuqi merr vendimin e duhur, brenda 30 ditëve, për ankimet e bëra kundër vendimeve të marra nga këshilli i bashkisë ose i komunës, në rastet kur ka konflikte interesash ndërmjet këshillit të komunës ose bashkisë që merr vendimin dhe ankuesit, gjë që sjell dëmtimin e këtij të fundit.

Neni 20

Seksionet e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore të këshillave të rretheve

- Në çdo rreth ngrihet dhe funksionon seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, detyrat kryesore të të cilit janë:
- a) drejtimi i institucioneve të përkujdesjes shoqërore që varen nga këshilli i rethit;
 - b) përgatitjen e kërkesave për marrjen e ndihmës nga Buxheti i Shtetit;
 - c) drejtimi dhe kontrolli i punës së administratorëve shoqërorë të bashkive dhe komunave;
 - ç) kualifikimi dhe këshillimi profesional i administratorëve shoqërorë të bashkive dhe komunave;
 - d) përgatitja e projektvendimit të këshillit të rethit për ankesat kundër vendimit të këshillit të bashkisë ose të komunës;
 - dh) marrja e informacionit nga këshillat e bashkive dhe komunave, si dhe analizimi i niveleve të varfërisë dhe i ndryshimit të tyre.

Neni 21

Vartësia e seksioneve të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore

1. Seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në rreth ka vartësi të dyfishtë nga këshilli i rethit dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.
2. Seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki ka vartësi të dyfishtë nga këshilli i bashkisë dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.
3. Seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në komunë ka vartësi të dyfishtë nga këshilli i komunës dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

KAPITULLI VI
DETYRAT E MINISTRISË SË PUNËS, EMIGRACIONIT, PËRKRAHJES SOCIALE DHE TË
PËRNDJEKURVE POLITIKË DHE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Neni 22

1. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë ka për detyrë të propozojë buxhetin e shpenzimeve për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore, si dhe të ushtrojë kontrollin, revizionimin dhe shmangien e përfitimeve të padrejta gjatë administrimit të tij. Ajo ka të drejtë të studiojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të marrë pjesë si vëzhguese në të gjitha mbledhjet që trajtojnë probleme të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore.

2. Për të kryer detyrat e parashikuara në paragrafin e mësipërm, Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë duhet:

a) të hartojë legjislacionin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore dhe të propozojë masën e ndihmës ekonomike në bazë të studimeve për këtë qëllim;

b) të kontrollojë institucionet publike dhe private të përkujdesjes shoqërore për të moshuarit, jetimët dhe të paafët mendorë e fizikë dhe të verifikojë zbatimin e kushteve të parashikuara nga ky ligj;

c) të përcaktojë kushtet e kontraktimit të institucioneve të përkujdesjes shoqërore me organizatat bamirëse joqeveritare;

ç) të përcaktojë kushtet e drejtimit dhe kriteret e puësimit të personelit në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore që varen nga pushteti qendror;

d) të ngrejë institucione të reja të përkujdesjes shoqërore me pjesëmarrjen e mundëshme të këshillave të rretheve, bashkive dhe komunave;

dh) të propozojë statusin profesional të personelit të institucioneve të përkrahjes shoqërore, të marrë masa për formimin dhe kualifikimin, dokumentimin e aftësive profesionale të tyre;

e) të zhvillojë programet e kualifikimit për politikën dhe punën shoqërore;

ë) të bëjë dhe drejtojë punën studimore shkencore për varfërinë, ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen shoqërore;

f) të autorizojë dhe regjistrojë organizatat joqeveritare që synojnë të veprojnë në fushën e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore dhe të bashkëveprojë me to për të realizuar synimet e politikës sociale shtetërore.

3. Minisrti i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë krijon komisionin e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore në nivel qendror, që ka për detyrë vendosjen e personave në institucionet e përkujdesjes shoqërore të drejtuara në nivel qendror.

4. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, së bashku me Institutin e Statistikës në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë:

a) studion nivelin e varfërisë dhe standartet minimale të jetesës;

b) organizon shërbimin statistikor.

Neni 23

Për plotësimin e detyrave që burojnë nga ky ligj, në Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë ngrihen dhe funksionojnë drejtoria e ndihmës ekonomike dhe drejtoria e përkujdesjes shoqërore.

Neni 23/a

Ministria e Financave dhe Ekonomisë përgjigjet për kontrollin e përdorimit të bllokndihmës dhe shpërndarjen e fondeve sipas kërkesave në Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

Pagesa e ndihmës ekonomike bëhet nga seksionet e financës në bashki e komuna.

Neni 24

Inspektorët e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore

1. Për kryerjen e detyrave të saj Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë krijon inspektoriatin e Ndhmës dhe Përkujdesjes Shoqërore dhe emëron inspektorët e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, që përgjigjen për disa rrethe, bashki i komuna.

2. Inspektorati nuk ndërhyr për të kufizuar ose për të marrë kompetencat e këshillit të rrethit, bashkisë ose komunës.

3. Inspektorët kanë të drejtë të kontrollojnë të gjitha dokumentet, që lidhen me dhënien e ndihmës ekonomike. Inspektorët e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore i raportojnë për të gjitha shkeljet Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, e cila merr masat e duhura sipas akteve të Këshillit të Ministrave.

KAPITULLI VII

RREGULLIMET FINANCIARE

Neni 25

1. Sistemi i bllokndihmës dhe përkujdesjes shoqërore financohet nga Buxheti i Shtetit. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, çdo tre muaj, u shpërndan seksioneve të financës në bashki e komuna shumë e bllokndihmës, duke mbajtur parasysh nevojën për ndihmë ekonomike në bashkinë ose komunën përkatëse.

2. Përcaktimi i nevojave bëhet duke u mbështetur në treguesit e mëposhtëm:

- a) struktura e popullsisë, veçanërisht sipas moshës dhe madhësisë së familjes;
- b) punësimi, të ardhurat dhe papunësia e popullsisë ekonomikisht aktive;
- c) të dhënat e shëndetit publik për nënushqyerjen dhe paaftësinë dhe
- ç) të dhënat e shpërndarjes së tokës.

KAPITULLI VIII

PROCEDURAT

Neni 26

Pretendimi për ndihmë

1. Ndhmë ekonomike jepet pasi bëhet kërkesa me shkrim nga kryetari i familjes. Kërkesa nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes.

2. Konsiderohen si kryetarë të familjes personat madhorë, sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes në grup-moshën aktive (18-60 vjeç), anëtari më i ri i familjes në grup-moshën mbi 60 vjeç dhe kujdestari, në rastin kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.

3. Kërkesa shoqërohet me:

a) dokumente që provojnë mungesën e të ardhurave dhe përfitimeve të tjera nga sigurimet shoqërore;

b) certifikatën e gjendjes familjare.

4. Mungesa e të ardhurave vërtetohet nga zyra e punës, agjencia e sigurimeve shoqërore, zyra e kadastrës, si dhe organe të tjera që vërtetojnë të ardhurat.

Neni 27

Shpërndarja e të ardhurave

Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj, me rekomandimin e administratorit shoqëror dhe me vendimin e këshillit të bashkisë ose të komunës.

Neni 28

Vendosje në institucione të përkujdesjes shoqërore

Kërkesa për vendosjen në institucione për të moshuarit, jetimët, individët me paaftësi fizike e mendore bëhet nga:

- kryetari i familjes ose
- administratori shoqëror a komisioni ekspert mjekësor.

Kërkesa i drejtohet këshillit të rrethit, bashkisë, ose komunës sipas vartësisë së institucionit dhe shoqërohet me deklaratën e pëlqimit nga personi përkatës, me kusht që ai të jetë madhor dhe i aftë mendërisht.

Neni 29

Ankimi

Në rastet kur pretenduesi për ndihmë nuk është i një mendimi me vendimin e këshillit të bashkisë ose të komunës, për dhënien e ndihmës ekonomike, ai ka të drejtë të ankohet në këshillin e rrethit brenda 15 ditëve nga data e marrjes njoftim për këtë vendim. Këshilli i rrethit vepron sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 30

Gjobat

Këshillat e bashkive dhe të komunave kanë të drejtë të dënojnë me gjobë për përfitimin e ndihmës ekonomike në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji deri në 3-fishin e shumës së përfituar. Personi përgjegjës për pagesën e gjobës duhet të jetë kryetari i familjes që ka bërë kërkesën me shkrim për ndihmë dhe, në mungesë të tij, personi që vjen menjëherë pas tij sipas përcaktimit të nenit 26.

Për ankimin kundër vendimit për gjobë zbatohet procedura e parashikuar në nenin 28 të këtij ligji.

KAPITULLI IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT, DETYRA FILLESTARE TË MINISTRISË SË PUNËS, EMIGRACIONIT, PÛRKRAHJES SOCIALE DHE TË PÛRNDJEKURVE POLITIKË

Neni 31

1. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe këshillat e rretheve, bashkive dhe komunave janë përgjegjës për zbatimin e sistemit.

2. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe drejtoria përkatëse e saj përgjigjen për:

- a) përcaktimin e planit të punës dhe fillimin e veprimtarisë në nivel rrethi, bashkie e komune;
- b) organizimin dhe realizimin e kualifikimit të kuadrit në të gjitha nivelet;
- c) për organizimin e fushatave të informimit publik dhe ndjekjen dhe kontrollin e zhvillimit të tyre;
- ç) inspektimin e punës për të shmangur keqadministrimin e ndihmës në nivel lokal;
- d) drejtimin e institucioneve të veçanta të përkujdesjes shoqërore që administrohen në nivel qendror;
- e) ndihmën e personave që pretendojnë kujdes publik në gjithë vendin;
- ë) organizimin dhe drejtimin e të gjithë institucioneve të vendit, pavarësisht nga vartësia e tyre;
- f) bashkërendimin e punës me organizmat joqeveritarë, vendas e të huaj, në fushën e përkujdesjes shoqërore.

Neni 32

Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë koordinon

gjithë veprimtarinë e saj, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, si dhe me Ministrinë e Arsimit, për kalimin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore në vartësi të saj.

Neni 33

1. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë kujdeset për ngritjen e seksioneve të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në çdo rreth, bashki e komunë, që realizojnë zbatimin e këtij ligji.

2. Në rastet kur e sheh të përshtatshme Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë emëron inspektorë të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore për disa rrethe, bashki ose komuna, të cilët i ndihmojnë ato për ngritjen e sistemit dhe funksionimin e tij.

DETYRAT FILLESTARE TË KËSHILLAVE TË RRETHEVE

Neni 34

Këshilli i rrethit ngre seksionin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në rreth. Ky seksion përgatit planin për:

a) integrimin gradual të programeve, të ndihmës ekonomike ekzistuese në një sistem të vetëm që ndiqet nga seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki dhe komunë;

b) marrjen graduale në ngarkim të tij të institucioneve ekzistuese të përkujdesjes shoqërore dhe çerdheve të rrethit.

Neni 35

Kryetari i këshillit të rrethit zgjedh dhe emëron nëpunësit për funksionimin e sistemit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në rreth dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, realizon kualifikimin e tyre.

DETYRAT FILLESTARE TË KËSHILLAVE TË BASHKIVE DHE KOMUNAVE

Neni 36

Këshillat e bashkive dhe komunave ngrenë seksionet e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore pranë tyre. Kryetari i bashkisë dhe i komunës emërojnë nëpunësit në seksionet përkatës të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë. Këshillat e bashkive dhe komunave sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin e sistemit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore.

Neni 37

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 38

Të gjitha dispozitat ligjore e nënligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi më datën 1 korrik 1993.

Shpallur me dekretin nr.550, datë 5.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

